

## AKT THEMELIMI

### I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"GEGA CENTER"

SH. P. K.

SHKODER

Ne baze te ligjit 7512 dt. 10. 8. 1991 "Per sanksionimin e mbrojtjen e prones private e privatizimit, te ligjit nr. 7638 date 19. 11.1992 "Per shoqerite tregtare", dhe te ligjit nr. 7667 date 28. 1. 1993 "Per rregjistrimin e shoqerive ne rregjistrin tregtar", me vullnetin tim te lire, te shprehur ne nenshkrimin e ketij akti, une, Paulin Pjeter Gega, dtl. 20 Gusht 1965, lindur e banues ne Beltoje, Komuna Berdice, Shkoder, kam krijuar shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "GEGA CENTER" Sh.p.k., Shkoder, me ortake te vetem dhe administrator Paulin Gega.

### OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Tregtim, me shumice dhe pakice, eksport-import, i artikujve te ndryshem industrial; ushqimore; ushqime per blegtorine; konfeksione; te gjithë llojeve te ndertimeve dhe punimeve te ndryshme ne fushen e ndertimit dhe ate elektrike; makineri e paisje; te paisjeve elektro-shtepiake; hidro-sanitare; materiale e lende ndertimi; linje per prodhim e tregtim inertesh; prodhime bujqesore e blegtorale, bime medicinale; te gjithë llojet e punimeve te drurit; agjenci turistike, hoteleri, bar - restorant, sherbime servisi; Tregtim me pakice karburante e lubrifikante, Pike gazi, e transport te tij; transport per vehte e te trete.

Për ato veprimtari qe kërkohet marrje licence, kjo shoqëri do te pajiset me dokumentet përkatëse sipas ligjit.

### SELIA E SHOQERISE.

Selia e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Gega Center" sh.p.k. Shkoder, do te jete ne Beltoje, Shkoder.

### KOHEZGJATJA

Jetegjatesia e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Gega Center" Sh.p.k. Shkoder, do te jete pa afat.

### KAPITALI THEMELOR OSE PJESET

Kapitali themelor fillestar i shoqerise "Gega Center" eshte 93.700.000 leke, i perbere nga :

C.A.SH.	leke	100.000, te depozituara ne Banke.
Ne natyre	leke	93.600.000, nga te cilat :
• Toke	leke	39.400.000
• Ndertesa	"	15.000.000
• Pika karburanti		39.200.000

qe jane kontribut i ortakut te vetem dhe administratorit te saj z. Paulin Gega.

Per te sanksionuar veprimtarine e vet, si dhe maredheniet e punes ne te gjithë fushat e saj, shoqeria do te kete e do te çele librin e saj, qe quhet "Libri i Shoqerise".

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "Gega Center" Sh.p.k., Shkoder, do te kete dhe do te mbaje llogarine e saj, duke u mbeshtetur tek leku shqiptar dhe valutat e huaja.

Maredheniet e punes ne shoqeri, do te rregullohen nepermjet kontrates se punes. Per çeshtjet qe nuk rregullohen me kontraten e punes, ato do te rregullohen ne baze te legjislacionit ne fuqi, me vendim te Ortakut te vetem, gjithmone sipas legjislacionit ne fuqi per kete çeshtje.

Kjo kontrate, pasi u lexue me ze te larte, u firmos nga ortaku i vetem dhe administratori i shoqerise "Gega Center" Sh.p.k., Shkoder :

Ortaku i vetem  
Paulin Gega

**S T A T U T**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**"GEGA CENTER"**

**SH. P. K.**

**SHKODER**

**NENI 1**

**EMERTIMI**

Ne baze te ligjit 7512 dt. 10. 8. 1991 "Per sanksionimin e mbrojtjen e prones private e privatizimit, te ligjit nr. 7638 date 19. 11.1992 "Per shoqerite tregtare", dhe te ligjit nr. 7667 date 28. 1. 1993 "Per rregjistrimin e shoqerive ne rregjistrin tregtar", me vullnetin tim te lire, te shprehur ne nenshkrimin e ketij akti, une, Paulin Pjeter Gega, dtl. 20 Gusht 1965, lindur e banues ne Beltoje, Komuna Berdise, Shkoder, kam krijuar shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "Gega Center" Sh.p.k., Shkoder, me ortake te vetem dhe administrator Paulin Pjeter Gega.

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "Gega Center" Sh.p.k. Shkoder, fiton personalitetin juridik nga dita e rregjistrimit te saj ne Gjykatën e Rrethit Gjyqsor Tirane. Ajo eshte person juridik shqiptar, dhe e zhvillon aktivitetin e vet ne perputhje me normat e legjislacionit shqiptar ne fuqi, dhe aktet e saj themeluese, si ky statut, si dhe kontrata qe i bashkohet dhe perben nje pjese te pandare te tij.

**NENI 2**

**OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

Objekti i veprimtarise ekonomike te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Gega Center" sh.p.k., Shkoder, eshte :

Tregtim, me shumice dhe pakice, eksport-import, i artikujve te ndryshem industrial; ushqimore; ushqime per blegtorine; konfeksione; te gjithë llojeve te ndertimeve dhe punimeve te ndryshme ne fushen e ndertimit dhe ate elektrike; makineri e paisje; te paisjeve elektro-shtepiake; hidro-sanitare; materiale e lende ndertimi; linje per prodhim e tregtim inertesh; prodhime bujqesore e blegtorale, bime medicinale; te

gjithë llojet e punimeve të drurit; agjenci turistike, hoteleri, bar - restorant, shërbime servisi; Tregtim me pakice karburante e lubrifikante, Pike gazi, e transport të tij; transport për vehte e të treta.

Për ato veprimtari që kërkohet marrje licence, kjo shoqëri do të pajiset me dokumentet përkatëse sipas ligjit.

### NENI 3 SELIA E SHOQERISE.

Selia e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Gega Center" sh.p.k. Shkoder, do të jete në Beltoje, Shkoder.

Aktiviteti i shoqërisë do të zhvillohet në rrethin e Shkodrës, por ai do të shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj. Qendra e shoqërisë, që është në selinë e sipërtreguar, është e rregjistruar në librin e shoqërisë "Gega Center" Sh.p.k. Shkoder. Kjo shoqëri mund të hapë filiale të saj në rrethe të ndryshme të vendit, apo dhe jashtë, duke zbatuar të gjithë legjislacionin në fuqi të vendeve ku do të hapen.

### NENI 4 JETEGJATESIA

Jetegjatesia e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Gega Center" Sh.p.k. Shkoder, do të jete pa afat.

### NENI 5 KAPITALI THEMELOR

Kapitali themelor fillestar i shoqërisë "Gega Center" është 93.700.000 leke, i përbërë nga :

- |                   |      |             |                          |
|-------------------|------|-------------|--------------------------|
| 1. C.A.SH.        | leke | 100.000,    | te depozituara në Banke. |
| 2. Në natyrë      | leke | 93.600.000, | nga të cilat :           |
| • Toke            | leke | 39.400.000  |                          |
| • Ndertesa        | "    | 15.000.000  |                          |
| • Pika karburanti |      | 39.200.000  |                          |

që janë kontribut i ortakut të vetëm të saj z. Paulin Gega.

### NENI 6 KUOTAT OSE PJESET

Ndryshimi i mases se kapitalit themelor, si per shtimin apo per pakesimin, e tij, behet me vendim te Ortakut te Vetem, ose me vendim te Asamblese se Ortakeve, n.q.s. do te shtohen ortake te tjere.

## NENI 7 DREJTIMI I SHOQERISE

Organi me i larte i shoqerise eshte Ortaku i vetem.

### NENI 7/1

#### KOMPETENCAT E ORTAKUT TE VETEM DHE DHENIA E VENDIMEVE

Ortaku i vetem drejton me vendime dhe ka keto kompetenca:

- Te marre vendime dhe te beje ndryshimet e nevojshme ne statut.
  - Te zgjeroje ose te kufizojte kompetencat e administratores se saj.
  - Vendos per shperndarjen, ndarjen ose bashkimin e shoqerise.
  - Ushtron te gjitha kompetencat qe i njeh ligji dhe statuti per ceshtje te vecanta.
- Te gjitha vendimet e Ortakut te Vetem do te hidhen ne proces verbale nga nje person i caktuar nga ortaku, dhe nenshkruar nga ato.

## NENI 8 ADMINISTRIMI

Shoqeria do te administrohet nga administratori i saj, qe ne rastin ne fjale eshte Ortaku i vetem, z. Paulin Pjeter Gega.

Administratori eshte organi administrativ i Shoqerise.

## NENI 9 KOMPETENCAT E ORGANIT ADMINISTRATIV

Kompetencat e organit administrativ caktohen nga statuti, vendimet e asamblese dhe ligji.

Organi administrativ ka kompetenca te gjera, qe perfshin te gjitha veprimtarine e zakonshme dhe te jashtezakonshme te shoqerise, si dhe gjithçka qe parashikohet ne ligj.

Organi administrativ ka keto kompetenca:

- Te marre pjese ne ankande.
- Te perpiloje kontrata dhe çdo akt tjeter juridik , te çdo lloji qofshin, qe kane te bejne me veprimtarine e shoqerise.
- Te perfaqsoje shoqerine ne te gjitha strukturat shoqerore dhe gjyqsore, ne te gjitha shkallet e ne te gjitha llojet, duke mbrojtur interesat e shoqerise.
- Te emeruje nepunes te rangjeve te ndryshme.

- Te hape llogari rrjedhese ne Bankat e Shqiperise, apo dhe jashte saj.
  - Te ndermarre reciprocitete financiare dhe hipotekuese, te marre pjese ne sipermarrje te tjera financiare te te gjitha llojeve.
  - Te bleje, te kembeje e te tjetersoje pasuri te ndryshme qe i sherbejne shoqerise.
  - Te marre ne pune dhe persona te tjere si specialiste etj., gjithmone me kontrate pune.
  - Te marre pjese, n.q.s. eshte e nevojshme, ne procedurat e falimentimit.
- Ky percaktim eshte rregull jo taksativ dhe nuk e kufizon fuqine e ketij organi.

## NENI 10 PERFAQSIMI

Perfaqsimi i shoqerise perballe te treteve eshte e drejte dhe detyre e administratorit te saj.

Administratori eshte pergjegjes para shoqerise dhe te treteve si per shkeljet ligjore, shkeljet e statutit, ose per fajet e kryera nga ata gjate administrimit te shoqerise.

### Neni 11

Per rastet kur e kerkon ligja, dhe kur e shikon te domosdoshme shoqeria, kontrolli i saj do te kryhet nga nje ekspert kontabel, i ngarkuar per kete qellim.

Eksperti caktohet nga ortaku i vetem.

### NENI 12

Te gjitha te punesuarit ne kete shoqeri jane te detyruar te ruajne sekretin e shoqerise gjate dhe ne rast se largohen nga puna.

## NENI 13 SHPERBERJA E SHOQERISE

Shperberja e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Gega Center" Sh.p.k. mund te vije ne çdo kohe dhe per çfaredo shkak, si per humbje te kapitalit te shoqerise, pamundesi veprimtarie, me vendim te Ortakut te vetem te shoqerise, apo kur e parashikon ligja.

### NENI 14

Me shperberjen e shoqerise caktohen nje ose disa likuidatore, duke ju caktuar detyra konkrete, ne radhe te pare per likuidimin e personave te trete, duke percaktuar dhe burimet e likuidimit.

NENI 15

Perso nuk eshte shprehur ne kete statut, i referohet plotesimeve qe do te beje Ortaku i vetem.

NENI 16

Ky statut, i cili permban pese faqe, u firmos rregullisht nga ortaku i vetem i shoqerise "Gega Center" Sh.p.k., Shkoder :

Ortaku i vetem

Paulin Gega

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E DREJTESISE  
DHOMA NOTERISE SHKODER

Nr.rep. 1147



AUTENTIFIKIM NENSHKRIMI

Sot me date 24 Prill 2006(dymije e gjashte), te henen, ne Dhomen e Noterise Shkoder, dhe para meje noter Arben Salim Kopliku, me seli ne Bulevardin "Mbreti Zog I-re", nr. 1, u paraqit personalisht z. Paulin Pjeter Gega, dtl. 20 Gusht 1965, lindur e banues ne Beltoje, Komuna Berdice, Shkoder. Nr. leje arme me foto 2/34 dt. 5. 10. 2000, per identitetin e te cilit jam i njohur personalisht, madhore e me te gjitha aftesite e kerkuara nga ligja, sipas kerkeses, vertetoj nenshkrimin e siperm:

Arben Salim Kopliku  
NOTER